



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2018

PËR

EUROBONDIN QË DO TË EMETOHET NGA MINISTRI
I FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE BLERJEN MBRAPSHT
(BUYBACK) TË NJË PJESE TË EUROBONDIT EKZISTUES,
MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E TAKSAT
DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË NGA IMUNITETI
NË MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Në marrëveshjet, që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit “Eurobond” dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, në përputhje me ligjin nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, të lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondit, menaxherët bashkëdrejtues dhe menaxheri për blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e

pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht nga të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e eurobondeve dhe me blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI